

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat e Kosovës



RAPORTI I MISIONIT

për

**Një sistem Cilësie për Statistikat
Faza I: Zhvillimi i hartës rrugore për implementimin e sistemit
te menaxhimit të cilësisë
Komponenti i pare**

Misioni i realizuar nga Hilka Vihavainen & Lars Thygesen

14-17 Janar 2014

Versioni: Perfundimtar

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-maili

*Lars Thygesen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +4539173941
Email: lth@dst.dk*

*Hilkka Vihavainen
Statistics Finland
Verkstadsgatan 13
FI-00022 Helsinki
Finland
Tel: +358 50 5002296
Email: hilkkal.vihavainen@gmail.com*

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	4
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	4
3.1. Rekomandim: Organizimi për cilësinë.....	5
Themelimi i Komitetit për Cilësinë (ose Grupi Drejtues për Cilësinë).....	5
Emërimi i një personi përgjegjës në pozitën e Menaxherit të Cilësisë	5
3.2 Rekomandim: Ngritja e kapaciteteve	5
3.3. Rekomandim: Metadata	6
3.4. Rekomandim: Përdoruesit	6
Aneksi 1. Termat e References	9
Aneksi 2. Personat e takuar	12

Lista e Shkurtesave

KPSE	Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KSC	Korniza e Sigurimit të Cilësisë (Eurostat)
TeR	Termat e Referencës

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport i misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat e Kosovës'. Është misioni i parë në komponentin e parë të projektit. Qëllimi i misionit ka qenë përcaktimi i një plani strategjik si bazë për implementimin e mëtejshëm të projektit në këtë fushë të statistikave.

Objektivat konkrete të misionit kanë qenë:

- Planifikimi i përgjithshëm i punës rreth cilësisë në ASK.
- Përcaktimi i hartës rrugore për të gjitha aktivitetet në kuadër të komponentit të parë.
- Diskutimet se si mund të organizohet më së miri planifikimi dhe puna rreth cilësisë në një Institut Statistikor Kombëtar (ISK).

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e konsulentëve dhe e kanë bërë qëndrimin në Kosovë të këndshëm dhe të paharrueshëm.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës/Statistikave të Finlandës.

2. Vleresimet dhe rezultatet

Ky aktivitet është realizuar në formë të një takimi pune me të gjithë pjesëmarrësit nga ASK-ja, të përfshirë në termat e referencës. Janë diskutuar të gjitha temat, që përmenden në termat e references. Takimi ka filluar me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane (KPSE) dhe Kornizën e Sigurimit të Cilësisë (KSC). Në lidhje me parimet, janë përshkruar indikatorët dhe pikat specifike në të dy dokumentet e BE-së, situata aktuale në ASK, si dhe janë definuar rekomandimet. Diskutimi i çështjeve ka qenë i gjallë dhe ka rezultuar në paraqitjen e një pasqyre të qartë të çështjeve, që duhet të adresohen në këtë komponent.

Gjatë takimit, ekspertët nga vendet anëtare kanë bërë këto prezantime:

- Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane
- Korniza e Sigurimit të Cilësisë
- Menaxhimi i Cilësisë në Statistikat e Finlandës
- Puna rreth cilësisë në Statistikat e Danimarkës
- Harta rrugore drejt 'parajsës': Strategjia për Statistikat e Kosovës
- Metadata në Statistikat e Danimarkës
- Konkluzionet dhe rekomandimet

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Rekomandimet janë të grupuara në katër tituj: Organizimi, ndërtimi i kapaciteteve, metadata dhe përdoruesit.

3.1. Rekomandim: Organizimi për Cilësi

Krijimi i Komitetit për Cilësi (ose Grupi Drejtues për Cilësi)

Do të duhej të formohej një Komitet i nivelit të lartë për Cilësi dhe të fillojë punën para fundit të prillit të vitit 2014. Puna e këtij grupi pastaj duhet të diskutohet gjatë aktivitetit 1.2, që pritet të mbahet në maj.

Detyrat e grupit duhet të përfshijnë:

- *Përkufizimin e deklaratës së përkushtimit për cilësi si dhe publikimi në web faqe në përputhje me Kodin e Praktikës*
- *Miratimin e modelit GSBPM si bazë për udhëzuesit për cilësi, udhëzuesit për metadata dhe menaxhimin e ASK-se (shih <http://www1.unece.org/stat/platform/display/GSBPM/GSBPM+v5.0>)*
- *Përgatitjen dhe miratimin e udhëzuesve dhe standardeve për cilësi për procese të punëve specifike;*
shembull:
 - *Procedurat për trajtimin e gabimeve në statistikat e publikuara*
 - *Udhëzuesin për mostra dhe vlerësime*
- *Të sigurojë që përkushtimi për cilësi dhe udhëzuesit për cilësi të kuptohen dhe të ndiqen nga të gjithë në organizatë.*

Kryesuesi i grupit duhet të vijë nga menaxhmenti i lartë, sepse detyrat e grupit janë shumë të rëndësishme për të gjitha proceset në ASK. Kjo poashtu duhet të jetë si një sinjal për gjithë organizatën që përkushtimi dhe udhëzuesit për cilësinë kanë prioritet të lartë.

Emërimi i një personi në pozitën e Menaxherit të Cilësisë

Është e rëndësishme të ketë një Menaxher për Cilësi, që është i përkushtuar për detyrat në vijim:

- *Mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe udhëzuesve për cilësi në tërë organizatën.*
- *Hartimi dhe diskutimi i udhëzuesve*
- *Përcjellja e punës ndërkombëtare në cilësinë në statistika dhe në këtë mënyrë informimi rreth praktikave më të mira, që mund të përdoren si inspirim.*
- *Sekretari i grupit drejtues*

Profili: Menaxheri për Cilësi idealisht do të duhej të kishte përvojë në disa fusha të statistikave. Ai ose ajo duhet të ketë dëshmuar në mënyrë të qartë se ka një mënyrë pune të organizuar dhe të menduar sistematik, si dhe ka demonstruar interesim për punën në cilësi.

3.2 Rekomandim: Ndertimi i kapaciteteve

Sipas ASK-së, sigurimi i cilësisë për të dhënat statistikore është përgjegjësi e krerëve të produkteve statistikore. Ata zakonisht e vlerësojnë cilësinë kur produkti (p.sh. publikimi) është gati. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që i gjithë stafi të kuptojë rëndësinë e cilësisë së produktit statistikor në të gjitha fazat e tij. Gjithashtu, është bërë e qartë se punonjësit e rinj të ASK-së në vecanti duhet të ndjekin trajnim specifik për statistikat pasi ky lloj trajnime nuk ofrohet në asnjë shkollë/universitet në Kosovë. Stafi i ASK-së ka nevojë për më shumë trajnime, në lidhje me çështjet e cilësisë, si dhe në përgjithësi për metodat dhe mjetet statistikore.

Bazuar në këto argumente, rekomandohet që:

- *Dy anëtarë të stafit të ASK-së të marrin pjesë në Konferencën e Cilesise- Q 2014 në Vienë prej 2-5 Qershor <http://www.q2014.at> . Është propozuar që ky aktiviteti të financohet nga projekti dhe Keshilli Drejtues i Projekti do të marrë këtë vendim në mbledhjen e parë. Q2014 është një ngjarje e rëndësishme evropiane, ku mund të shihet se çfarë po bëhet në lidhje me cilësinë në agjenci të ndryshme statistikore. Së paku njëri prej pjesëmarrësve duhet të jetë personi, që do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe koordinimin e punës rreth cilësisë në ASK.*
- *Gjatë misionit të ardhshëm, në Maj të 2014, si pjesë e misionit të tyre, dy konsulentët do të mbajnë një ditë trajnim për cilësi për anëtarët e stafit të fushave të ndryshme statistikore. Trajnimi mund të përfshijë p.sh. temat në vijim:*
 - *Cilësia në Statistika*
 - *Dimensionet e cilësisë në Sistemin Statistikor Evropian*
 - *Procesi i Cilësisë*

ASK-ja do të përpilojë draftin e programit të trajnimit për stafin. Programi i trajnimit do të përpilohet në bazë të nevojave që identifikohen në organizatë. Rekomandohet që para misionit të ardhshëm të bëhet një hulumtim për mangësitë e mundshme dhe nevojat për trajnime. Mund të bëhet në mënyrë sistematike nga ana e menaxherëve të njësive. Para misionit të ardhshëm konsulentët do të shikojn për mundësitë që ofrohen nga kurset e-mësimëve. ASK do të shikojë se a do të mbahen gjatë vitëve të ardhshëm kurse Evropiane (të financuara p.sh. nga programi IPA). Qëllimi pastaj është të finalizohet programi i trajnimit gjatë verës 2014.

3.3.Rekomandim: Metadata

ASK-ja ka filluar të publikojë përshkrimet për metadata bazuar ne formatin e ESMS. <http://esk.rks-gov.net/ENG/metadata>. Deri tani janë publikuar vetëm disa përshkrime. Megjithatë, nuk ka një sistem azhurnimi të përshkrimeve aktuale. Është thënë që sistemi është jo efektiv pasi nuk bazohet në ndonjë databazë. Për këtë arsye është e nevojshme të vendoset një sistem, që është teknikisht më i avansuar, mund të shfrytëzohet për qëllime të ndryshme dhe në planin afatgjatë mund t'i kontribuojë sistemit të integruar për metadata. Projekti i SIDA-s i Suedisë përfshin poashtu një komponent, që ka për qëllim zhvillimin e një sistemi për metadata në ASK.

Bazuar në këto argumente, është konstatuar se:

- *Raportet e Cilesise sipas ESMS ne web faqe janë një fillim i mirë*
- *Por azhurnimi duhet të bëhet gjithsesi*
- *Duhet të mbulohen të gjitha fushat*
- *Duhet të vendoset nje sistem teknik*
- *Duhet të sigurohet koordinimi me projektin SIDA në mënyrë që të shmanget përfshirja e aktiviteteteve të njëjta.*
- *Se shpejti një mision (misioni nr 1.3.1) që do te percaktoje drejtimin e aktiviteteteve.*

3.4. Rekomandim: Përdoruesit

Publikimi ne web faqe të statistikave ka rritur padyshim numrin e përdoruesve të statistikave në Kosovë krahasuar me të kaluarën. Një prej detyrave kryesore është nxitja e mëtejme e përdorimit të informatave statistikore. Ka mënyra të ndryshme për ta arritur këtë. Është shumë me rëndësi të takohen përdoruesit dhe të pyeten për kërkesat e tyre dhe mangësitë e mundshme në lidhje me produktet statistikore. Pasi të merren mendimet e tyre, është shumë e rëndësishme që ato të analizohen në mënyrë të duhur dhe të nxirren konkluzione për përmirësime të mëtejme.

Për këtë arsye rekomandohet që;

- *Të mbahet një Konferencë me përdoruesit kyç*

- *Kjo do të duhej të përfshihej në aktivitetin e paraqitjes së fillimit të projektit, që do të mbahet në fillim të marsit apo prillit 2014*
- *ASK-ja mund të përdorë ekspertët e projektit që të ndihmojnë në lidhje me seminarin me përdoruesit në fusha të ndryshme.*
- *Në aspektin afatgjatë duhet të mbahen mbledhje të rregullta me grupe të përdoruesve p.sh. një herë në vit, p.sh. në:*
 - *Statistikat sociale*
 - *Statistikat ekonomike*
- *ASK-ja të fillojë me përdorimin e anketave lidhur me kënaqshmërinë e përdoruesve duke parë shembuj të këtyre anketave, që përdoren në vendet e tjera.*
 - *Anketa në lidhje me besueshmërinë e publikut në përgjithësi sipas standardeve të OECD <http://www.oecd.org/std/50021100.pdf>*
 - *Duhet të ndërmerren edhe anketa të tjera me përdoruesit për të matur se sa janë ata të kënaqur me produkte të caktuara statistikore, me web faqen, me qasjen në një database diseminimi; një shembull mund të jetë. http://www.dst.dk/~media/Kontorer/16-Formidlingscenter/maal-og-resultater/report_on_usersatisfaction_survey_statbank2007-pdf.pdf*
 - *Në misionin e ardhshëm konsulentët do të duhej të rishikojnë punën që është kryer deri në atë kohë dhe do të ofrojnë rekomandime për anketat*
 - *Ekspertët do të dërgojnë më shumë shembuj së shpejti.*

Puna në të ardhmen

- Numri i misionëve të parashikuara në kuadër të komponentit të parë është mjaft i madh. Edhe pse stafi i ASK-së ka vullnetin dhe interesimin për të pranuar informacione të reja, për të zhvilluar sistemet e tyre dhe adaptuar qasje të reja, realizimi i gjithë këtyre misionëve të parashikuara në afatin kohor të dhënë mund të mbingarkojë stafin dhe të vështirësojë përballimin e punëve të rregullta ditore. Për këtë arsye është propozuar që aktiviteti 1.0.2. do të implementohet sipas planit
- Aktivitetet 1.1.1 dhe 1.1.2 do të mbahen sipas planit
- Aktivitetet 1.2.1.1 dhe 1.2.1.2 do të rikonsiderohen duke u bazuar në rezultatet e aktivitetit 1.2.1
- Aktivitetet 1.3.1.1-1.3.1.5 do të rikonsiderohen bazuar në rezultatet e aktivitetit 1.3.1
- Aktiviteti 1.4.1 do të implementohet sipas planit

Veprimet, që duhet ndërmerren për përgatitjen e misionit të ardhshëm

Veprimi	Afati	Personi përgjegjës
Termat e referencës për aktivitetin 1.3.1 lidhur me Metadata	Shkurt 2014	RTA bashkë me ASK-në
Krijimi i Grupit Drejtues për cilësi	Sa më shpejt që është e mundur, më së voni deri në fund të prillit 2014	Menaxhmenti i ASK-së
Emërimi i Menaxherit të Cilësisë	Sa më shpejt që është e mundur, më së voni deri në fund të prillit 2014	Menaxhmenti i ASK-së
Përpilimi i përkushtimit për cilësi/politikës për cilësi	Në fund të prillit 2014	Grupi Drejtues i Cilësisë
Vendimi mbi pjesëmarrjen në Q2014 Vjenë	Mars 2014	Këshilli Drejtues i Projektit

Termet e referencës për aktivitetin 1.0.2	Prill 2014	RTA bashke me ASK-në
Identifikimi i mangësive të mundshme dhe nevojave për zhvillim kompetencash në ASK	Mars 2014	ASK-ja
Mundësitë për mësim përmes internetit (e-learning)	Maj 2014	Ekspertët e vendeve anëtare
Hartimi i draftit të programit për trajnime mbi cilësinë	Prill 2014	Ekspertët e vendeve anëtare
Programi për konferencën me përdoruesit	Shkurt 2014	RTA së bashku me ASK-në
Pyetësori mbi kënaqshmërinë e përdoruesve	Janar 2014	Ekspertët e vendeve anëtare

Aneksi 1. Termat e References



Projekti i Binjakëzimit i BE-se KS12 IB ST 01 Përkrahje për Statistikat

Termat e References:

Komponenti 1: Sistemi i Cilësisë për Statistikat

Aktiviteti 1.0.1: Faza I: Zhvillimi i hartës rrugore për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 16 Dhjetor 2013

Fillimi / fundi i aktivitetit: 14-17 Janar 2014

Koha e raportimit: 28 Janar 2014

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ 1.1	Azhurnimi i planit statistikor të punës	- Standardizimi i procedurave për zhvillimin e produkteve statistikore të prezantuar deri në fund të tremujorit të 4 të projektit - Raportet e Cilësisë sipas standardeve të Eurostatit të përgatitura në 2 fusha të caktuara deri në tremujorin e 8-të të projektit	- Plani statistikor i punës - Raportet tremujore nga ana e Projektit të Binjakëzimit - Raportet e misioneve - Raportet mbi Cilësinë	- Përkushtimi dhe disponueshmëria në të gjitha nivelet e stafit të ASK-së dhe menaxhmentit - Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes misionëve - Resurse të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale)
Rezultati obligativ 1.2	Përgatitja e politikave dhe udhëzuesve për implementimin e sistemit për cilësi	Udhëzuesi për sigurimin të cilësisë dhe dokumentimi i proceseve të produkteve statistikore, të përgatitur si draft deri në fund të tremujorit të 4 të projektit	- Raportet tremujore nga ana e Projektit të Binjakëzimit - Raportet e misionit	

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 1.0.1

Planifikimi i përgjithshëm i punës rreth cilësive në ASK – definimi i hartës rrugore për të gjitha aktivitetet në komponentin 1. Diskutimet se si të organizohet më së miri planifikimi dhe puna rreth cilësive në një Institut Kombëtar të Statistikave (IKS).

ASK-ja paraqet idetë e tyre si dhe konceptin në lidhje me statistikat zyrtare në të ardhmen; ekspertët e vendeve anëtare paraqesin konceptin e planifikimit strategjik, kornizave të cilësisë, monitorimin e strategjisë si dhe Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane; takim pune me menaxhmentin e lartë për të definuar së bashku misionin, vizionin dhe objektivat me fokus në plotësimin e nevojave të përdoruesve dhe furnizuesve të statistikave, dhe krijimin e kulturës për përmirësim të vazhdueshëm.

Rezultati i pritur nga aktiviteti 1.0.1:

Raporti i misionit, ku përshkruhet gjendja e tanishme në fushën e cilësisë në ASK. Gjatë projektit të binjakëzimit nevojitet një hartë rrugore e detajuar e aktiviteteve për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e tanishme të BE-së për cilësinë. Zhvillimi i listës së politikave dhe udhëzuesve, që do të zhvillohen në kuader të komponentit 1.2 - Aktivitetet e Projektit të Binjakëzimit të harmonizohen dhe koordinohen me aktivitetet e SIDA-s në fushat e njejta në lidhje me softverin dhe metodologjinë.

Resurset e ASK-se:

Z. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, ramiz.ulaj@rks-gov.net ASK (Udhëheqës i komponentit)
Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; ibrahim.rustemi@rks-gov.net
Hazbije Qeriqi, Përgjegjëse për Komunikim dhe Informim; hazbije.qeriqi@rks-gov.net
Arta Salihu, Zyrtare e Larte per Koordinim; arta.salihu.morina@rks-gov.net
Burim Limolli Shef i TI-se; burim.limolli@rks-gov.net
Bekim Canolli, Shef i Divizionit të Metodologjisë; bekim.canolli@rks-gov.net
Drita Sylejmani, Zyrtare e Larte per Diseminim, drita.sylejmani@rks-gov.net

Ekspertët e vendëve anëtare:

Ms Hilka Vihavainen, Zëvendëse e Drejtorit të Përgjithshëm, Statistika e Finlandës, hilka.vihavainen@gmail.com
Mr Lars Thygesen, Drejtor, Shitje dhe Marketing, Statistika e Danimarkës, lth@dst.dk

Resurset e Projektit të Binjakëzimit:

Mr Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk
Ms Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Sfondi

ASK-ja përshkruan disa procedura për monitorimin e cilësinë në faza të ndryshme procesit të produktit statistikor, prej planifikimit dhe dizajnit të anketës deri te mbledhja, përpunimi, analizimi dhe shpërndarja e të dhënave. Rekomandimet e Eurostatit dhe praktikat më të mira më shumë përdoren si udhëzues. Zhvillimi i cilësisë dhe i trajnimeve kryesisht ofrohet nga ekspertët ndërkombëtarë.

AGA e fundit (Adapted Global Assessment) mbi sistemin statistikor të Kosovës thekson se ASK-ja duhet të zhvillojë një politikë dhe plan për menaxhim të përmirësimit të cilësisë (duke përfshirë masat organizative, procedurat, trajnimet dhe veprimet specifike). Pjesë e rëndësishme e kësaj do të jetë përmirësimi i dokumentimit/metadatat (duke përfshirë edhe çështje metodologjike dhe të cilësisë që përmirësojnë transparencën). Në përgjithësi ka një baraspeshë adekuate për sa i perket saktësisë dhe afatit kohor.

Aktivitetet në komponentin 1 të Projektit të Binjakëzimit do të përmbajnë një numër të aktiviteteve, që janë të dizajnuara për realizimin e matjes sistematike të cilësisë.

Aktivitetet, që duhet të ndëmirren si parapergatitje për misionin:

ASK-ja duhet të sigurojë informatat nevojshme për ekspertët e vendeve anëtare:

Lista e dokumentave – Mund t'i bashkangjitet termave të referencës në email, të përfshira si aneks, ose duke iu referuar web faqes:

- Adapted Global Assessment report (AGA)
- Programi i Statistikave Zyrtare 2013 -2017
- Plani i Zhvillimit Strategjik 2009- 2013

Të aranzhojë takimet e nevojshme me subjekte relevante të jashtme:

Lista e takimeve me subjektet relevante jashtë ASK-së mund të përfshihet në programin e misionit

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për vitin e ardhshëm në fushën e cilësisë
- Zhvillimi i planit të detajuar për aktivitetet e projektit të binjakëzimit -

Rezultati i pritur:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim
- Plani i detajizuar për aktivitetet e ardhshme në komponentin 1 nga ana e projektit të binjakëzimit
- Versioni i azhurnuar i planit të veprimit për cilësi – i gatshëm që të merret në konsideratë nga menaxhmenti i lartë i ASK-së

Programi - Janar 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	Hotel Sirius	08:00	RTA takon ekspertët në Hotel Sirius
	ASK	09:00	Planifikimi i javës
		09:30	ASK: Përshkrimi i gjendjes aktuale në fushë e cilësisë në ASK si dhe perspektiva në të ardhmën
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	VA: Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane për Cilësi
		12:00	Dreka
		13:15	VA: Menaxhimi i Cilësisë i Statistikave të Danimarkës dhe Finlandës
		14:30	Pushim për kafe
		15:00	Koordinimi me projektin SIDA
		16:30	Konkluzionet preliminare
2	ASK	09:00-16:00	Seminari: (Programi të kompletohet)
3	ASK	09:00	Takime të tjera
		10:30	Pushim për kafe
		10:45	Vazhdim: Dakordimi për rekomandimet dhe afatet kohore
		12:00	Dreka
		15:00	Takim me udhëheqësin e projektit në ASK: rekomandimet, afatet kohore dhe programi i punës
4	ASK	09:00	Shkrimi i raportit
		10:30	Pushim për kafe
		10:00	Shkrimi i raportit
		12:00	Dreka
		13:15	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Isa Krasniqi, Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së

Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, ramiz.ulaj@rks-gov.net ASK (Udhëheqës i komponentit)

Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; ibrahim.rustemi@rks-gov.net

Hazbije Qeriqi, Përgjegjëse për Komunikim dhe Informim; hazbije.qeriqi@rks-gov.net

Arta Salihu, Zyrtare e Larte per Koordinim; arta.salihu.morina@rks-gov.net

Burim Limolli Shef i TI-se; burim.limolli@rks-gov.net

Bekim Canolli, Shef i Divizionit të Metodologjisë; bekim.canolli@rks-gov.net

Drita Sylejmani, Zyrtare e Larte per Diseminim, drita.sylejmani@rks-gov.net

Illir T. Berisha, Drejtor i Departamentit te Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare,

Illir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i projektit:

Per Knudsen, RTA

Nora Zogaj, asistente e RTA

Valdet Hadri, përkthyes (në disa misione)